



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 534/12 prot.

Datë 09.04.2026

V E N D I M
Nr.492/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Gjergj Mersini	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 09.04.2026, mori në shqyrtim çështjen me,

- Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të KPP nr. 442/2026, datë 30.03.2026, për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-73301-12-24-2025, me objekt: “Blerje motoçikletash për Policinë e Shtetit”, me fond limit 34,359,316.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 28.01.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Moto Tirana” SHA me NIPT K21512004G dhe adresë: Bulevardi “Bajram Curri”, Tiranë.
- Operatori ekonomik “inAuto” SHPK me NIPT M31417021V dhe adresë: Bashkia Tirane, Njesia Administrative Nr. 11, Rruga “Gjoke Doci”, Numri i pasurise 630/449, Zona Kadastrale 832, Tiranë
- Autoriteti Kontraktor:** Operatori i Blerjeve të Përqendruara me adresë Rruga “Rreshit Çollaku” Godina Nr. 6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë).
- Subjekte të Interesuara:** Operatori ekonomik “inAuto” SHPK me NIPT M31417021V dhe adresë: Bashkia Tirane, Njesia Administrative Nr. 11, Rruga “Gjoke Doci”, Numri i pasurise 630/449, Zona Kadastrale 832, Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:**I***Rrethanat e çështjes*

I.1. Në datën 30.03.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.442/2026 ku vendosi:

1. *Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Moto Tirana” SHA në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-73301-12-24-2025, me objekt: “Blerje motoçikletash për Policinë e Shtetit”, me fond limit 34,359,316.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 28.01.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.*
2. *Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “inAuto” SHPK në procedurën e sipërpërmendur të prokurimit.*
3. *Autoriteti kontraktor të rivlerësojë ofertën e operatorit ekonomik “inAuto” SHPK sipas konstatimeve të shprehura në këtë vendim.*
4. *Autoriteti kontraktor brenda pesë ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera*
5. *Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Moto Tirana” SHA dhe operatori ekonomik “inAuto” SHPK.*
6. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
7. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. 4351/13 prot., datë 03.04.2026 protokolluar me tonën nr. 534/9 prot., datë 07.04.2026 autoriteti kontraktor njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr. Nr.442/2026 datë 30.03.2026, për procedurën e prokurimit E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-73301-12-24-2025, me objekt: “Blerje motoçikletash për Policinë e Shtetit”, me fond limit 34,359,316.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 28.01.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton:

II.1 Me shkresën nr. 4351/13 prot., datë 03.04.2026 protokolluar me tonën nr. 534/9 prot., datë 07.04.2026 autoriteti kontraktor njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr.442/2026 datë 30.03.2026, për procedurën e prokurimit E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-73301-12-24-2025, me objekt: “Blerje motoçikletash për Policinë e Shtetit”, me fond limit 34,359,316.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 28.01.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

II.2. Komisioni i Prokurimit Publik verifikoi veprimet e kryera në sistemin e prokurimeve elektronike, lidhur me zbatimin e vendimit Nr.442/2026 datë 30.03.2026, të Komisionit të Prokurimit Publik. Nga ky verifikim rezultoi se, autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësim të procedurës object ankimi, në zbatim të vendimit Nr.442/2026 datë 30.03.2026 të këtij komisioni, duke skualifikuar operatorin ekonomik “inAuto”SHPK.

Për sa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-73301-12-24-2025, me objekt: “Blerje motoçikletash për Policinë e Shtetit”, me fond limit 34,359,316.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 28.01.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

